



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 521/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Xhevdet Abazi kryesues, Nenad Lazić dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkritazi për apelin e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje(LVV) me seli në Prizren, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2013, mori këtë:

**V E N D I M**

**HIDHET** si e palejuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

**A r s y e t i m**

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 04.11.2013, nga subjektit politik LVV, me të cilën pretendohet se me datën 03.11.2013 një veturë zyrtare e tipit Golf në QV 2004A, është parë duke u përdorur për bartje të personave deri në këtë QV.

PZAP-i, gjeti se:

**Ankesa Apeli është i palejuar**

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it të datës 06.11.2013, Anr. 500/2013. Pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të kësaj çështje të theksuar në apel. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e nenit 9.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it ,si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr.521/2013. më datën 08.11.2013

**Kryesuesi i Panelit**  
**Xhevdet Abazi**



**Udhëzim Juridik:**

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore*